

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 430 Prot.

Tiranë, më 30.03 2017

VENDIM Nr. 46, datë 24.03.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5 të datës 24.03.2017, pasi shqyrtoi Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së gërmimit arkeologjik të shpëtimit në zonën e përcaktuar *si zonë me potencial arkeologjik Chance Find, Lapardha KP 156+380, të Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së gërmimit arkeologjik të shpëtimit në zonën e përcaktuar *si zonë me potencial arkeologjik Chance Find, Lapardha KP 156+380, të Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila do të realizojë gërmimin arkeologjik të shpëtimit, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik që do të realizojë mbikëqyrjen e atë.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes disa palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria e Teknikës për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURNHI
MINISTËR

SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO